



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**VENDIM**

nr.332 , datë 09.10.2014

**Për miratimin e udhëzimit**

**“Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.10.2014, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e Udhëzimit “Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese”

**Baza ligjore:** Neni 8,9 dhe 24, shkronja d), dh) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Projekt Udhëzimit ‘Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese’;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

**V Ë R E N S E:**

1. Sekretari i Përgjithshëm ka paraqitur për miratim në Komision Projekt Udhëzimin “Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese” në zbatim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

2. Udhëzimi “Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese” është i përshtatur me legjislacionin europian në fushën e konkurrencës dhe në mënyrë specifike nenin 82 të Traktatit të BE-së për sjelljet abuzive nga ndërmarrjet me pozitë dominuese (52009XC0224(01);(2009/C45/02)(OJ C 45,24.02.2009,p.7-20).
3. Ky udhëzim do t'i shërbejë Autoritetit të Konkurrencës dhe palëve të interesuara për një interpretim sa më të gjerë të nenit 8 (pozita dominuese) të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, dhe nenit 9 (abuzimi me pozitën dominuese).

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës

### **V E N D O S I:**

1. Të miratojë Udhëzimin ‘Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese’ sipas tekstit të bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete Gruda**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Koço Broka**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Iva Zajmi**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Rezana Konomi**

(\_\_\_\_\_)

**Zv/Kryetar**

**Lindita MILO(LATI)**

---

**K R Y E T A R**